


Mbështetur në nenin 34 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, Ligjin Nr. 05/L-009 dhe Ligjin Nr. 08/L-276, në Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, në Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, në Udhëzimin Administrativ Nr. 10/2021 për Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor, si dhe në pajtim me Statutin e Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale e Ujësjiellësit "Hidromorava" Sh.A. (në tekstin e mëtejme: Kompania), Bordi i Drejtorëve i Kompanisë, miraton:



RREGULLORE PËR OPERIMIN, MONITORIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E INFRASTRUKTURËS SË SHFRYTËZIMIT TË UJIT NË KRU "HIDROMORAVA" SH.A.

**RREGULLORE PËR OPERIMIN, MONITORIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E
INFRASTRUKTURËS SË SHFRYTËZIMIT TË UJIT NË KRU
“HIDROMORAVA” SH.A., GJILAN**

**KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Kjo Rregullore përcakton procedurat, përgjegjësitë dhe standardet për operimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së shfrytëzimit të ujit, me qëllim të sigurimit të furnizimit të qëndrueshëm, të sigurt dhe cilësor me ujë.

**Neni 2
Fusha e Veprimit**

2.1. Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha objektet dhe asetet infrastrukturore të Ndërmarrjes, duke përfshirë:

1. Burimet ujore;
2. Rezervuarët;
3. Stacionet e pompimit;
4. Rrjetin e ujësjellësit;
5. Pajisjet elektromekanike;
6. Impiantet e trajtimit të ujit;
7. Sistemet SCADA;
8. Sistemet GIS.

**Neni 3
Korniza Ligjore**

3.1. Kjo Rregullore mbështetet por nuk kufizohet në legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës që rregullon:

1. Menaxhimin e ujërave;
2. Ofrimin e shërbimeve publike;
3. Mbrojtjen e mjedisit;
4. Sigurinë dhe shëndetin në punë.

**Neni 4
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin si në legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës për ujërat, shërbimet publike, mbrojtjen e mjedisit, sigurinë dhe shëndetin në punë, përveç rasteve kur nga konteksti kërkohet ndryshe.

2. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) Kompania – Kompania Rajonale e Ujësjes ose institucioni përgjegjës për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë;

b) Infrastrukturë ujore – të gjitha asetet dhe objektet që përdoren për kapjen, trajtimin, transportimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e ujit;

c) DMA (District Metered Area) – zonë e matur dhe e izoluar hidraulikisht, ku monitorohen prurjet, presioni dhe humbjet e ujit;

ç) MNF – Minimum Night Flow – Rrjedhjes Minimale të Natës

d) PRV – (Pressure Reducing Valve) - valvulë për Reduktimin e Presionit

dh) SCADA – sistemi i mbikëqyrjes, kontrollit dhe mbledhjes së të dhënave në kohë reale;

e) GIS (Geographic Information System) – sistemi gjeografik informativ për regjistrimin, menaxhimin dhe analizimin e aseteve infrastrukturore;

ë) PLC - Programmable Logic Controller – Kontrollues Logjik i Programueshëm

f) “Mirëmbajtje parandaluese” – aktivitetet e planifikuara për parandalimin e defekteve dhe zgjatjen e jetëgjatësisë së aseteve;

g) Mirëmbajtje reaktive (korrigjuese) – aktivitetet e ndërmarra pas paraqitjes së një defekti ose avarie;

gj) “Aset” – çdo objekt, pajisje, instalim ose infrastrukturë që përdoret në sistemin e furnizimit me ujë;

h) UPS - Uninterruptible Power Supply – Pajisje për furnizim të pandërprerë me energji elektrike

i) VFD – Variable Frequency Drive – Drejtues i frekuencës së ndryshueshme

Neni 5

Struktura Përgjegjëse për zbatimin e Rregullores

5.1.Departamenti Teknik i Ndërmarrjes është përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

5.2.Zbatimi realizohet në koordinim me njësitë teknike, njësinë GIS/SCADA, laboratorin dhe Menaxhmentin e Ndërmarrjes.

KAPITULLI II

OPERIMI I INFRASTRUKTURËS SË SHFRYTËZIMIT TË UJIT

Neni 6

Operimi i Burimet Ujore

- 6.1. Burimet ujore monitorohen vazhdimisht për sasinë, cilësinë dhe sigurinë operationale.
6.2. Evidencat dhe raportet operative mbahen në baza ditore dhe mujore.

Neni 7

Operimi me Rezervuarët dhe me Stacionet e Pompimit

- 7.1. Rezervuarët dhe stacionet e pompimit inspektohen dhe pastrohen periodikisht.
7.2. Gjatë inspektimeve kontrollohen:
a) Nivelet e ujit;
b) Presioni;
c) Pompat;
d) Valvulat;
e) Gjeneratorët;
f) Sistemet elektromekanike.
7.3. Pastrimi i rezervuarëve të ujit të pijes kryhet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi për cilësinë e ujit të pijes dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujësjellësit, përfshirë Udhëzimin Administrativ përkatës të Ministrisë së Shëndetësisë për Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor.

Neni 8

Operimi i Rrjetit të Ujësjellësit

- 8.1. Operimi i rrjetit të ujësjellësit realizohet përmes monitorimit të:
1. Presionit;
2. Prurjes (rrjedhës);
3. Stabilitetit hidraulik të sistemit.

KAPITULLI III

MENAXHIMI I ZONAVE TË MATURA (DMA-ve) DHE REDUKTIMI I HUMBJEVE TË UJIT

Neni 9

Menaxhimi i Zonave të Matura (DMA) dhe Humbjeve të Ujit

1. Zonat e matura (DMA) monitorohen për identifikimin e humbjeve fizike dhe komerciale të ujit.

2. Analizat realizohen përmes të dhënave të matjes, sistemit SCADA dhe sistemit të faturimit.
3. Menaxhimi i DMA-ve përbën shtyllën kryesore të strategjisë për reduktimin e ujit të humbur dhe kontrollin e rrjedhjeve në një zonë të izoluar hidraulikisht.

9.1. Menaxhimi Operacional dhe Analitika e të Dhënave

9.1.1. Monitorimi i Rrjedhjes Minimale të Natës (MNF – Minimum Night Flow)

1. Rrjedhja minimale e natës është treguesi më kritik për identifikimin e rrjedhjeve.
2. Matja kryhet zakonisht ndërmjet orës 02:00 dhe 04:00.
3. Çdo rritje e pashpjegueshme e MNF-së konsiderohet indikator i rrjedhjeve fizike ose humbjeve komerciale.

9.1.2. Bilanci Ujor

1. Çdo muaj realizohet krahasimi ndërmjet:
 - 1.1. Volumit të ujit që hyn në DMA përmes matësit kryesor;
 - 1.2. Konsumit total të regjistruar nga ujëmatësit e konsumatorëve.

9.1.3. Menaxhimi i Presionit

1. Presioni i lartë rrit shkallën e rrjedhjeve dhe rrezikun e plasjes së gypave.
2. Në pikat hyrëse të DMA-ve instalohen valvula reduktuese të presionit (PRV) për mbajtjen e presionit në nivele optimale.

9.2. Mirëmbajtja Fizike e DMA-ve

9.2.1 Testimi i Integritetit të Kufijve të DMA zonave

1. Të gjitha valvulat kufitare mbyllen për verifikimin e izolimit të DMA-së.
2. Monitorohet matësi kryesor dhe presioni brenda zonës.
3. Nëse regjistrohet rrjedhje ose presioni i ujit nuk bie sipas pritjeve, kryhen kontrole për valvulat kufitare.

9.2.2. Kalibrimi dhe Verifikimi i Ujëmatësve

1. Ujëmatësit elektromagnetikë ose ultrasonikë pastrohen dhe kalibrohen periodikisht.
2. Çdo devijim matës ndikon drejtpërdrejt në llogaritjen e humbjeve të ujit.

9.2.3. Lokalizimi i Rrjedhjeve (Leak Detection)

1. Kur evidentohet rritje e MNF-së, aktivizohen ekipet e terrenit.
2. Lokalizimi kryhet me korrelatorë, gjeofonë dhe regjistruar të zhurmës (noise loggers).

9.2.4. Menaxhimi i Valvulave Kufitare

1. Valvulat që izolojnë zonën duhet të mbahen të mbyllura sipas konfigurimit të aprovuar.
2. Çdo ndryshim i statusit të valvulës regjistrohet në sistemin GIS.

9.2.5. Leximi i Rrjedhjes Minimale të Natës

1. Leximi i MNF-së realizohet çdo ditë përmes SCADA ose telemetrisë.

9.2.6. Inspektimi i Pusetave dhe Pajisjeve

1. Kontrollohen ujëmatësit, dataloggerët dhe valvulat.
2. Inspektimi kryhet çdo muaj për identifikimin e lagështisë, depërtimit të ujit dhe dëmtimeve fizike.

9.2.7. Përditësimi i GIS-it

1. Çdo ndryshim në rrjet, kyçje të re ose zëvendësim gypi regjistrohet në GIS.

KAPITULLI IV

MIRËMBAJTJA E RRJETIT TË UJËSJELLËSIT

Neni 10

Mirëmbajtja Parandaluese e Rrjetit të Ujësjiellës

10.1. Mirëmbajtja e Rrjetit të Ujësjiellës:

1. Detektimi i rrjedhjeve të fshehura përmes pajisjeve akustike dhe korrelatorëve.
2. Monitorimi i presionit përmes manometrave dhe valvulave reduktuese të presionit (PRV).
3. Inspektimi vizual i pusetave, nyjeve dhe lidhjeve për lagështi, korrozion dhe dëmtime strukturore.

10.2. Mirëmbajtja e Valvulave dhe Hidrantëve:

1. Manipulimi periodik i valvulave për të parandaluar bllokimin.
2. Testimi, pastrimi, lubrifikimi dhe kontrolli i funksionalitetit të hidrantëve.

10.3. Pastrimi i Rrjetit,

1. Shpërlarja (Flushing) e rrjetit për largimin e sedimenteve dhe biofilmit.

2. Dezinfektimi periodik me klor ose agjentë të tjerë dezinfektues.

3. Pastrimi dhe dezinfektimi periodik i rezervuarëve.

10.4. Mirëmbajtja e Pajisjeve Elektromekanike:

1. Servisimi i pompave, lubrifikimi, monitorimi i vibrimeve dhe temperaturës.

2. Kalibrimi dhe zëvendësimi periodik i ujëmatësve.

3. Mirëmbajtja e sistemeve SCADA dhe sensorëve të monitorimit.

10.5. Mbrojtja nga Korrozioni dhe Ndikimet Atmosferike:

1. Mirëmbajtja e sistemeve të mbrojtjes katodike.

2. Izolimi termik i rrjetit dhe pusetave për sezonin dimëror.

Neni 11

Mirëmbajtja Reaktive (Korrigjuese) e Rrjetit të Ujësjetës

11.1. Riparimi i Shpërthimeve dhe Rrjedhjeve të Dukshme

1. Riparimi i gypave kryesorë dhe shpërndarës.

2. Zëvendësimi i segmenteve të dëmtuara.

3. Riparimi i kycjeve shtëpiake deri te ujëmatësi i konsumatorit.

11.2. Ndërhyrjet në Valvula dhe Pjesë Fazonike

1. Riparimi ose zëvendësimi i valvulave dhe pjesëve fazonike.

2. Riparimi ose zëvendësimi i PRV-ve.

3. Riparimi i hidrantëve dhe ventilave të ajrit.

11.3. Sanimi i Defekteve në Objekte Ndihmëse dhe Stacione Pompimi

1. Ndërhyrjet emergjente në stacionet e pompimit.

2. Riparimi i dëmtimeve në rezervuarë.

11.4. Punët Ndihmëse dhe Ndërtimore

1. Gërmimi dhe sigurimi i gropave të punës.

2. Riasfaltimi dhe rikthimi i terrenit në gjendjen e mëparshme.

KAPITULLI V

MENAXHIMI I ASETVE, GIS DHE SCADA

Neni 15

GIS, SCADA dhe Sistemet SMART

1. Të gjitha asetet infrastrukturore regjistrohen në sistemin GIS.
2. Monitorimi në kohë reale realizohet përmes SCADA dhe teknologjive SMART.

Neni 12

Menaxhimi i të Dhënave dhe Planifikimi (GIS)

1. Përditësimi i GIS-it me të dhënat e tubacioneve, materialeve, moshës dhe historikut të defekteve.
2. Përditësimi i GIS-it me të dhënat e pompave, pajisjeve elektromekanike dhe historikut të defekteve.

KAPITULLI VI

MIRËMBAJTJA E IMPIANTEVE TË TRAJTIMIT TË UJIT TË PIJES

Neni 13

Mirëmbajtja Parandaluese e Impianteve të Trajtimit të Ujit të Pijes

13.1. Pajisjet Mekanike dhe Elektromekanike

1. Mirëmbajtja e pompave të ujit të papërpunuar, pompave dozuese dhe pompave të presionit të lartë.
2. Kontrolli i sistemeve të koagulimit dhe flokulimit.
3. Kontrolli i sistemeve të shpëlarjes së filtrave (backwash).
4. Mirëmbajtja e ventilave dhe aktuatorëve.

13.2. Sistemet e Filtrimit dhe Trajtimit

1. Kontrolli i filtrave me rërë dhe karbon aktiv.

2. Pastrimi periodik i dekanterëve.

13.3. Sistemet e Dozimit të Kimikateve

1. Kalibrimi i pompave dozuese.
2. Pastrimi i rezervuarëve dhe linjave të dozimit.

13.4. Instrumentimi, Automatizimi (SCADA) dhe Elektropajisjet

1. Kalibrimi i sensorëve.
2. Kontrolli i paneleve elektrike.
3. Testimi i gjeneratorëve dhe UPS-ve.

Neni 14

Mirëmbajtja Reaktive (Korrigjuese) e Impianteve të Trajtimit të Ujit të Pijes

14.1. Defektet Mekanike të Pajisjeve

1. Zëvendësimi i menjëhershëm i pompave të dëmtuara.
2. Riparimi ose zëvendësimi i ventilave kryesorë.

14.2. Defektet e pajisjeve elektrike dhe të Automatizuara

1. Zëvendësimi i ndërprerësve, kontaktorëve dhe frekuentorëve (VFD).
2. Riparimi i dështimeve në SCADA, PLC dhe sensorë.

14.3. Emergjencat e Procesit të Trajtimit

1. Ndërhyrjet e menjëhershme në rast të ndryshimeve në cilësinë e ujit të papërpunuar.
2. Sanimi i rrjedhjeve të ujit ose kimikateve brenda impiantit.

KAPITULLI VII

SIGURIA, RAPORTIMI DHE DOKUMENTIMI

Neni 16

Siguria dhe Shëndeti në Punë

1. Personeli teknik është i obliguar të zbatojë standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë.
2. Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale është i detyrueshëm gjatë të gjitha ndërhyrjeve.

Neni 17
Evidencat dhe Raportimi

1. Çdo intervenim, mirëmbajtje dhe inspektim dokumentohet në formularët standard të Ndërmarrjes.
2. Evidencat ruhen sipas procedurave të menaxhimit të dokumentacionit.

KAPITULLI VI
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 18
Dispozita kalimtare

1. Të gjitha çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore në mënyrë të veçantë, rregullohen sipas legjislacionit përkatës.


Neni 19
Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
2. Me miratimin e kësaj Rregulloreje, shfuqizohen të gjitha aktet e brendshme që e kanë rregulluar këtë fushë.

Gjilan, 19.06.2026



**U.D.Kryesuesi i Bordit të
Drejtorëve**


z.Habil Zeqiri